

SHKOLLA E MESME PEDAGOGJIKE

PJESA I

GJUHË SHQIPE

Incidenti ndodhi më 23 dhjetor, në orën 4 mbasdite. Ai u zhvillua brenda një kohe tepër të shkurtër, sa të hapësh dhe të mbyllësh sytë, por ngjarja ishte nga ato që kanë aftësinë ta ndajnë kohën më dysh...

...Sa më shumë kalonin orët, aq më i rëndë dukej incidenti. Nata e zmadhoi trupin e tij në një mënyrë të pabesueshme. Ditët që erdhën më pas, gjithashtu. Qetësia që pllakosi gjithë atë javë pas tij, në vend që ta shuante, e rriti edhe më. Në mendjet e të gjithëve përsëriteshin e përsëriteshin, të ngadalësuara si në kllapi, ato lëvizje kaotike mbi urë. Ato ishin si një skicim i parë i luftës. Tani ishte e qartë se ajo patrullë s'ishte e rastit. Nga të gjitha anët vijnë lajme të këqija. Në bazën e Vlorës, në principatën e Topiajve, te Dukagjinët dhe Kastriotët në veri, kudo turqit kanë shpërthyer një valë incidentesh. (Ismail Kadare, "Ura me tri harqe")

1. Shprehjen frazeologjike *sa të hapësh e të mbyllësh sytë* zëvendësoje me një fjalë të vetme sinonime me të. _____ **1 pikë**
2. Gjej një çift antonimesh të përdorura në fragment. **1 pikë**
3. Në cilin ndërtim fjala *valë* është përdorur me kuptimin e parë? **1 pikë**
 - A) Turqit kanë shpërthyer një valë incidentesh.
 - B) I dhashë vetëm një valë gjellës.
 - C) Nga përplasja e valës mbi shkëmb u formua një re piklash.
 - D) Tani jemi në valën e punës.
4. Në ç'rasë është emri *incidentesh* në fjalinë e fundit të fragmentit? **1 pikë**
5. Në ç' shkallë është mbiemri i përdorur në fjalinë:
Ai u zhvillua brenda një kohe tepër të shkurtër...? _____ **1 pikë**

Matura Shtetërore 2007, Teste

6. Në fjalinë: *Nga të gjitha anët vijnë lajme të këqija*, fjala të gjitha është: **1 pikë**
- A) përemër vetor
B) përemër i pacaktuar
C) përemër lidhor
D) përemër pronor
7. Në ç' mënyrë janë foljet e përdorura në shprehjen frazeologjike *sa të hapësh e të mbyllësh sytë?* **1 pikë**
8. Në cilin ndërtim folja *filloj* është përdorur si folje gjysmëndihmëse? **1 pikë**
- A) Nuk dihet se kur do të fillojë ndërtimi i urës.
B) Puna atë ditë kishte filluar më herët se ditët e tjera.
C) Mos fillo përsëri tani!
D) Djali filloi të lexojë para se të niste klasën e parë.
9. Ktheje fjalinë e mëposhtme në formën joveprore. **1 pikë**
Nata e zmadhoi trupin e tij në një mënyrë të pabesueshme.
10. Gjej kryefjalën në fjalinë e mëposhtme dhe trego me se është shprehur ajo. *Nga të gjitha anët vijnë lajme të këqija* **2 pikë**
a. Kryefjala: _____ b. Shprehur me:

11. Nënvizu kallëzuesin në fjalinë e mëposhtme dhe trego llojin e tij. **2 pikë**
Në mendjet e të gjithëve përsëriteshin e përsëriteshin, të ngadalësuara si në kllapi, ato lëvizje kaotike mbi urë.
Lloji: _____
12. Trego funksionin e grupit emëror të nënvizuar në fjalinë e mëposhtme. **1 pikë**
Në bazën e Vlorës, në principatën e Topiajve, te Dukagjinët dhe Kastriotët në veri, kudo turqit kanë shpërthyer një valë incidentesh.

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

- 13.** Çfarë është grupi emëror i nënvizuar në fjalinë e mëposhtme. **1 pikë**
Nga të gjitha anët vijnë lajme të këqija.
- A) rrethanor vendi
 - B) rrethanor mënyre
 - C) kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
 - D) rrethanor kohe
- 14.** Fjalja: *Tani ishte e qartë se ajo patrullë s'ishte e rastit* është: **1 pikë**
- A) fjali e thjeshtë
 - B) fjali e përbërë përmbyllëse
 - C) fjali e përbërë ftilluese – kryefjalore
 - D) fjali e përbërë ftilluese – kundrinore
- 15.** Shtoji fjalisë së mëposhtme një pjesë tjetër, në mënyrë që fjalia të dalë e përbërë me bashkërenditje kundërshtuese. **1 pikë**
Incidenti ndodhi më 23 dhjetor, në orën 4 mbasdite.
- 16.** Gjej fjalën e shkruar gabim. **1 pikë**
- A) Të vegjëlit
 - B) Mbrëtërit
 - C) Blerësit
 - D) Të egrit
- 17.** Gjej foljen e shkruar gabim. **1 pikë**
- A) Shtënça
 - B) Thënça
 - C) Ardhça
 - D) Vdeksha
- 18.** Qarko fjalinë ku është përdorur drejt shkronja e madhe. **1 pikë**
- A) Kopluku ndodhet në Malësinë e Madhe.
 - B) Kopluku ndodhet në Malësinë e madhe.
 - C) Kopluku ndodhet në malësinë e Madhe.
 - D) Kopluku ndodhet në malësinë e madhe.

PJESA II

FLOBER- “Zonja Bovari” (fragment)

Megjithatë, ajo nganjëherë mendonte se ato ditë të para të martesës ishin më të bukurat e jetës së saj, muaji i mjaltit, siç thuhet. Që ta shijonte nektarin e tyre, e mira ishte të kalonte nëpër ato vende me emra kumbues, ku ditët e para pas martesës kalohen në një plogështi aq të këndshme! Hipur në ndonjë karrocë poste, me perde mëndafshi të kaltër nga brenda, ngjitesh ngadalë nëpër rrugët e rrëpirëta, duke dëgjuar gurgullimën e shurdhët të ujëvarës. Kur perëndon dielli, ngopesh me erën e këndshme të limonave në breg të gjive të detit; pastaj në mbrëmje, duke ndenjtur mbi tarracën e vilave, vetëm për vetëm dhe kapur dorë për dorë, vështron yjet dhe bën plane për të ardhmen. Ajo mendonte se në këtë rruzull tokësor disa vende duhet të krijonin lumturi, si ndonjë bimë e veçantë që çel mbarë në një vend dhe që s’bëhet dot askund tjetër. Përse të mos prehej edhe ajo, mbështetur mbi bërryla në ballkonin e ndonjë vile zvicerane, a të mbyllej bashkë me trishtimin e saj në ndonjë shtëpizë fusharake skoceze, si bashkëshorte e një burri të veshur me frak kadifeje të zezë me kinda të gjatë dhe me çizme prej lëkure të butë, me kapelë me majë dhe me mansheta!

Ndoshta do të kishte dëshirë t’ia hapte zemrën ndokujt për të gjitha këto ëndërrime. Po si mund ta shprehte një siklet të pakapshëm, që ndërronte trajtë si retë, që vërtitej si vorbull ere? Nuk gjente dot fjalët, domethënë rastin, i mungonte guximi.

Megjithatë, asaj i dukej se, po ta donte Sharli një gjë të tillë, po ta kishte parandier, po të ishte puqur qoftë edhe një herë të vetme shikimi i tij me mendimet e saj, zemra do t’i zbrazej përnjëherë nga gjithë ajo ngarkesë, ashtu siç bien frutat e pjekura të pemëve sa vë dorën në to. Mirëpo, sa më shumë i lidhte jeta bashkëshortore, aq më tepër në brendësi të shpirtit ajo shkëputej prej tij.

Bisedat që bënte Sharli ishin të rrafshëta si trotuare rrugësh dhe në to qarkullonin mendime dosido të njerëzve me veshje aq të zakonshme, sa s’të ngjallnin asnjë emocion, s’të bënin as të qeshje, as të ëndërroje. Kur banonte në Ruan, i thoshte ai, s’ishte bërë asnjëherë kureshtar të shkonte të shihte ndonjë shfaqje në teatër me aktorë nga Parisi. S’dinte as të notonte, as të bënte skermë, as të gjuante me pisqollë, bile, një ditë, nuk kishte qenë në

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

gjendje t'i shpjegonte asaj një term të të hipurit në kalë, të cilin ajo e kishte hasur në një roman.

Mirëpo, a nuk është e domosdoshme vallë që burri të shkëlqejë në shumë drejtime, ta bëjë bashkëshorten të njohë forcën e pashtershme të dashurisë, shijet e stërholluara të jetës, të gjitha të fshehtat? Ndërsa ai s'i mësonte asaj asgjë, s'dinte kurrëgjë, s'kishte asnjë dëshirë. Kujtonte se ajo ishte e lumtur; dhe ajo e kishte inat që ai s'e prishte fare terezinë, që s'dilte kurrë nga ajo plogështi e patrazuar, që e ndiente bile veten të lumtur prej saj.

Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

- 1. Cili është, sipas Floberit, qëllimi i veprës letrare? **1 pikë****
 - A) Bukuria dhe vërtetësia.
 - B) Krijimi i tipit letrar.
 - C) Shkrirja e shkrimtarit me personazhet.
 - D) Zbërthimi i temave universale.

- 2. Çfarë nënkupton termi “bovarizëm”? **1 pikë****
 - A) Dashuri dhe tradhti.
 - B) Ëndërrim dhe zhgënjim.
 - C) Jetë dhe vdekje.
 - D) Nënshtrim dhe fatalitet.

- 3. Ç'lloj romani është “Zonja Bovari”? **1 pikë****
 - A) Psikologjik.
 - B) Historik.
 - C) Sentimental.
 - D) Simbolist.

- 4. Cila është karakteristika kryesore e personazhit të Emës? **1 pikë****
 - A) Ambicia për para.
 - B) Etja për të jetuar.
 - C) Kundërvënia ndaj mjedisit.
 - D) Dëshira për vepra madhore.

Matura Shtetërore 2007, Teste

5. Si shfaqet Sharli në vepër? **1 pikë**
A) Mendjengushtë.
B) Ambicioz.
C) Krenar.
D) Aventurier.
6. Ndaje fragmentin e dhënë në tri pjesë dhe formulo me një fjali se për çfarë flet secila prej tyre. **3 pikë**
7. Gjej në fragment detaje konkrete që flasin për fantazitë e Emës dhe vizatojnë karakterin e saj. Bazuar në to, portretizo fare shkurt figurën e heroinës. **3 pikë**
8. Lexo me kujdes pasazhin më poshtë:
*“...Mirëpo, sa më shumë i lidhte jeta bashkëshortore, aq më tepër në brendësi të shpirtit ajo shkëputej prej tij.
Bisedat që bënte Sharli ishin të rrafshëta si trotuare rrugësh dhe në to qarkullonin mendime dosido të njerëzve aq të zakonshme, sa s’ të ngjallnin asnjë emocion, s’ të bënin as të qeshje, as të ëndërroje.”*
Cilat janë dy fjalët-kyç në këtë pasazh, me të cilat jepet natyra e marrëdhënieve ndërmjet Emës dhe Sharlit? Cila është figura stilistike që shpreh thelbin e këtij raporti? Shpjego pse Ema e ndien si nevojë të domosdoshme të ëndërruarit? **3 pikë**
9. A na parapërgatit Floberi për një tragjedi të mundshme të mëvonshme? Arsyeto përgjigjen duke u mbështetur në fragment. **3 pikë**
10. Zbulo disa momente ku ironizohen të dy personazhet. Ç’regon kjo për stilin e Floberit? **3 pikë**
11. Cilat janë shkaqet që ndikuan në formimin e karakterit dhe në fatin e Emës? A ngjan ajo si jashtë kohës dhe realitetit apo e gjykoni për keq, ashtu si mjedisi i saj? (Kujto se Floberi luftoi në gjyq për ta mbrojtur të vërtetën e Emës.) A i tundojnë edhe të rinjtë e sotëm iluzione të tilla për lumturinë? Argumento mendimin tënd në formën e një eseje. **10 pikë**